

Me poshte jepet informacioni i kerkuar ne piken **4 dhe 5** te Formularit tip 1: NJOFTIMI PER INFORMIM NGA KERKUESI PRANE AKM/ARM/NJQV KU DO TE KETE VENDNDODHJEN INSTALIMI PER APLIKIM PER TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TE INSTALIMIT TE TIPIT B

**4. Pershkrimi i veprimtarise qe parashikohet te zhvillohet ne instalim.**

**5. nje pershkrim i elementeve te listuara ne formularin informues.**

---

**4. Pershkrimi i veprimtarise qe parashikohet te zhvillohet ne instalim**

Subjekti "Arna" Sh.p.k., ne NIPT: K14128001J, me seli ne Boboshtice Korce, me administrator zotin Jani Arqile Kapurani, kerkon per t'u pajisur me leje mjedisi te tipit B per aktivitetin "Rritje intensive e shpendëve në një instalim: 40000 - 1000 (krerë) vende shpendësh" sipas pikes 7.8 te shtojces nr. 1 te lligjit nr. 60\2014 "Per nje ndryshim ne ligjin nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"" me vendndodhje ne Boboshtice, qarku Korce.

Subjekti "Arna" Sh.p.k. eshte pajisur me leje mjedisore me nr.prot. 642\20, date 28.12.2009, Vendimi nr. 11 i Komisionit te Lejeve, per aktivitetin "Rritje e Intensive pulave per mish", te cilen e gjeni bashkelidhur.

Objekti ndodhet rreth 1 kilometer ne larg fshatit Boboshtice, ne krah te djathte te rruges Korce – Boboshtice, ndersa therrtorja (e pajisur me leje mjedisi) qe sherben per therrjen e pulave e cila edhe kjo eshte ne pronesi te subjektit "ARNA" Sh.p.k. ndodhet ne krah te majte te kesaj rruge, pothuajse perballe njera tjetres, pra kjo gje eshte pozitive, pasi te dy objektet ndodhen teper prane, rreth 200 metra distance. Shihni planimetrine e objekteve me pamje satelitore me poshte.

Siperfaqja e truallit ku eshte i ndertuar instalimi i mbareshtimit intensiv te pulave eshte rreth 4000 m<sup>2</sup>, ndersa siperfaqja e ndertimit ku bejne pjese rreth 8 kapanone eshte ne total rreth 1700 m<sup>2</sup>.

Kapaciteti total i mbarshimit te zogjve te pules per mish eshte 28000 krere. Keto 28000 krere jane te vendosur ne 8 kapanone, ku seiciki nga kapanonet kane rreth 3000 – 3500 krere zogj.

### **Karakteristikat kryesore**

#### **Pershkrimi i procesit**

Zogjte kompania i siguron nga inporti dhe merren per rritje per mish ata jane zogj 24 oresh.

Te cilet vendosen menjeher ne kapanonin perkates i cili eshte i pajisur me kaldaje per te siguruar ngrohtesine e nevojshme ne fazat e par ate rritjes.gjate periudhes se rritjes, zogjte i nenshtrohen vaksinimit ndaj semundjeve te ndryshme, i cili kryhet sipas nje skeme perkatese te miratuar nga veterineri. Zogjte qendrojne ne kete kapanon per nje periudhe 45 diteshe kohe ne te cilen zogjte jane gati per tu therrur per mish.

Per funksionimin e nje lokali per rritjen e pulave per mish jane te domosdoshme keto paisje:

1. Sistemi i ushqimit i perber nga:

- a) Sillosi i ushqimit
- b) Gypi
- c) Tub percjelles
- d) Plastike e perthyeshme
- e) Mjet per lidhjen e tubave
- f) Udhezues
- g) Tub me prize
- h) Sensor
- i) Faqja anesore e nderteses se kapanonit
- j) Shneku

Ushqimi vjen nga Fabrika e "Prodhimit te ushqimeve per kafshe" qe ndodhet Brenda ndertesës dhe kalon ne enet e ushqimit. Linjat e ushqimit perbehen nga enet e montuara ne tubat qe sjellin ushqim nepermje vihet ne levizje nga nje elektromotorr, kalimi i ushqimit nga sillosi qe eshte vendosur jashte kapanonit ne bunkerin qe eshte vendosur Brenda kapanonit dhe me pas ne enet e ushqimit ku marrin ushqim zogjte nga di nepermjet komandave qe jepen nga nje panel qendror qe eshte vendosur ne paradhomen e kapanonit. Enet e ushqimit, me rritjen e zogjeve ngrihen ne lartesi te ndryshme. Kjo behet ne funksion te kerkeses se zogut dhe realizohet ne menyre mekanike.



